



| | | | |
|--|--------------------------|---------------------|---|
|  Republika e Kosovës | Drejtoria për Shëndetësi | |  Komuna e Istogut |
| | Nr.1132/2022 | Data: 22.11.2022 | |



QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE-ISTOG

Në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nenit 68 i Ligjit Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Nr. 06-L/114, si dhe nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, konform Statutit të Q.K.M.F-së në Istog shpall:

K O N K U R S

1.Titulli i vendit të punës: Teknik/e i/e Labororit, në QKMF.

Numri i Referencës: 1132/2022

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Niveli i pagesës: 4.8

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Periudha e kontratës është: Në kohë të pacaktuar (6 Muaj Periudha Provuese)

Punët dhe detyrat:

- Bënë pergaditjen për sterilizimin e instrumenteve të nevojshme laboratorike për marrjen e materialit laboratorik nga pacientët,
- Varësisht nga testet që kryhen në laborator, të merr, të pergadisë, të analizoj dhe të asgjesoj në menyrë të sigurt të gjitha mostrat klinike,
- Shkruan, shpërndan dhe arkivon rezultatet e testeve të ndryshme laboratorike,
- Përdorë dhe mirëmban të gjitha paisjet laboratorike ,
- Jep këshilla pacientëve për mënyrën e marrjes së mostrave,
- Pergaditë , klasifikon dhe sterilizon enët laboratorike
- Kryen edhe punë të tjera profesionale specifike për shërbimin përkatës.

Kualifikimet, shkathtësit kyqe, aftësit dhe përvoja.

- Shkolla e Mesme e Mjekësisë-Drejtimi teknik i labororit /Fakulteti i Infermierisë- bachellor- Drejtimi teknik i labororit,
- Minimum stazhi i Obliguar Profesional;
- Të jetë i licencuar.
- Përvoja e punës e dëshirueshme.

Dokumentët e kërkuara:

Diploma e shkollës së mesme ose e fakultetit;

Licencën e Punës

Dëshmi për përvojën e punës.

Dokumenti i Identifikimit

Dëshmi nga gjykata që nuk je nën Hetime

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pas kalimit të afatit prej 30 ditësh nga dita e shpalljes nga NJMBNJ në web faqe – SIBMNJ (shpallja nga data 22.11.2022 deri me datë 21.12.2022) nga data 22.12.2022 deri me datë 05.01.2023 është afati 15 ditë kalendarike për marrjen dhe paraqitjen e aplikacioneve për pozitën e shpallur.

Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionet në **Qëndren Kryesore të Mjekësisë Familjare – Istog** -Zyra e Shërbimit Juridik (ditëve të punës prej 07:00 deri në ora 15:00) dhe aplikacionet e plotësuara dorëzohen në të njëjtën zyre.

Me Kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të mbahet intervista nga komisioni .

Për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.

